

V E N D I M
Nr.350, datë 8.2.1991

**PËR MASAT QË DUHEN MARRË LIDHUR ME PËRCAKTIMIN E VENDIT DHE TË
ROLIT TË USHTRISË, TË ORGANEVE TË PUNËVE TË BRENDËSHME DHE TË
DREJTËSISË NË KUSHTET E PLURALIZMIT POLITIK**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës;

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË
SHQIPËRISË

V E N D O S I:

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave, që për t'iu përgjigjur kërkesave të shtetit ligjor, të organizojë punën për studimin dhe hartimin e projektligjeve lidhur me vendin dhe rolin e ushtrisë, të organeve të punëve të brendëshme e të drejtësisë në kushtet e pluralizmit politik.
2. Në përgatitjen e projektligjeve të mbahet parasysh që forcat e armatosura i përkasin dhe janë vetëm në shërbim të Atdheut. Ato udhëhiqen dhe zbatojnë politikën e shtetit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurimit të RPSSH. Në forcat e armatosura e ushtarakët edukohen në frymën e patriotizmit, të vendosmërisë për mbrojtjen e lirisë e të pavarsisë së Atdheut, të paprekshmërisë së kufijve dhe të sigurimit të interesave të tij e të popullit.
3. Projektligjet e mësipërme, pasi të jenë diskutuar në ushtri, në organet e punëve të brendëshme dhe ato të drejtësisë, t'i paraqiten për shqyrtimin e miratim Kuvendit Popullor që do të dalë nga zgjedhjet e 31 Marsit 1991. Gjatë këtij procesi komandat ushtarake të marrin masa që të mos preket disiplina dhe gadishmëria luftarake e forcave të armatosura.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË**

SEKRETARI
Sihat Tozaj

KRYETARI
Ramiz Alia